



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:150852

Datë: 19.09.2022

Numri i dokumentit: 03437353

C.nr.807/20

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtarja Afijete Sada – Gllogjani, me bashkëpunëtorin profesional Zef Qupi, duke vendosur në çështjen juridike të paditësit A.L nga fshati..., Komuna e Gjakovës, të cilin e përfaqëson Feride Xani, avokate në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensim të shpenzimeve të ushqimit, vlera kontestit 1,344.00euro, pas përfundimit të shqyrtimit përgaditor – publik, të mbajtur me 08 shtator 2022, në prezencë të autorizuarës së paditësit dhe në mungesë të paditurës, 19 shtator 2022, murr këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesëpadia e paditësit A.L nga fshati..., Komuna e Gjakovës, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit në emër të kompensimit të ushqimit – shujtave për ditët e pranisë në punë, respektivisht për 672 ditë pune, për periudhën kohore 18 prill 2017 – 23 tetor 2020, të ia paguajë shumën prej 1,344,00 (një mijë e treqind e katër dhjetë e katër), me kamatë prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 08 shtator 2022, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 259.20 euro (dyqind pesëdhjetë e nëntë euro e njëzet cent), në afatin prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësi në padinë e parashtruar në këtë gjykatë, (të precizuar me dt.09 qershor 2022) përmes të autorizuarës së tij, ka parashtruar se i njëjti është i punësuar ne shkollën “Shtjefen Kurti”, në fshatin Novosellë e Epërme si punëtor teknik. Sipas nenit 35, paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit, e nënshkruar mes Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Kulturës shprehimisht thuhet se “të punësuarve, iu sigurohet kompensim në ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është prej 2.00 euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet e arsimit”. Paditësi me anë të kërkesës drejtuar Komunës së Gjakovës – DKA ka kërkuar që të përmbushët Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë në atë mënyrë që paditësit. të ia paguaj shpenzimet e ushqimit në shumën prej 2.00 euro për ditë të punës mirëpo Komuna e Gjakovës nuk i është përgjigjur kërkesës me të cilën i është drejtuar dhe nuk ka ndërmarr ndonjë veprim për përmbushjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës. Duke pasur parasysh se e paditura nuk ka vepruar sipas Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, paditësi ka parashtruar padi dhe ka bërë precizimin e saj me të cilën ka kërkuar që të obligohet Komuna e Gjakovës – DKA që paditësit të ia paguaj kompensim në ushqim për çdo dite punë nga 2.00 euro për 672 ditë të pranisë në punë në shumën prej 1,344.00 euro.

E autorizuar e paditësit në shqyrtimin përgatitor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë së ushtruar pranë kësaj gjykate, ashtu që duke u bazuar në vërtetimin për ditët e punës të lëshuar nga Shkolla “Shtjefën.Kurti” në Novoselë e Epërme paditësit për gjithsejtë 672 ditë pune ti paguhet kompensimi për ushqim në shumën e përgjithshme prej 1,344.00 euro.

E autorizuar e paditësit në fjalën e saj përfundimtare deklaroi se pas administrimit të provave konsideroj se ka prova të mjaftueshme dhe se padia ka bazë ligjore andaj i propozoi gjykatës që padia e paditësit të aprovohet dhe të njëjtit ti bëhet kompensimi i shumës për ditët e punës sipas precizimit të padisë së datës 09 qershor 2022, përkatësisht shumën prej 1,344.00 euro.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar dhe atë 20.00 euro për taksë gjyqësore, 104.00 euro për përpilimin e padisë, dhe 135.20 euro për përfaqësim në një seancë, përkatësisht shumën e përgjithshme në vlerë prej 259.20 euro.

Gjykata ia ka proceduar këtu të paditurës aktvendimin e datës 06 nëntor 2020 (për dhënien e përgjigjes së detyrueshme në padi) padinë dhe provat materiale, të cilat e njëjta i ka pranuar me datë 25 nëntor 2020 (siç vërtetohet nga fletë kthesë e cila gjendet në shkresat e lëndës), mirëpo e paditura nuk ka parashtruar përgjigje në padi, përkundër obligimit ligjor.

Me propozimin e të autorizuarës së paditësit dhe në kuptim të nenit 409 paragrafi 2 të LPK-së, Gjykata shqyrtimin përgatitor e mbajti në mungesë të të paditurës së ftuar në mënyrë të rregullt.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike gjatë shqyrtimit përgatitor ka bërë administrimin e provave si në vijim: Kontratën e punës datë 01 shtator 2015, Leg.nr.2788/20 datë 16 nëntor 2020, vërtetimi i SBASHK-ut datë 23 tetor 2020, vërtetimi i Shkollës “Shtjefën Kurti” nr.27 datë 23 tetor 2020, ku pas analizimit të fakteve juridike relevante të kësaj çështje, vlerësimit veç e veç të provave dhe lidhshmërinë e tyre reciproke, e në kuptim të nenit 8 të LPK-së, vërtetojë se kërkesëpadia e precizuar e paditësit, është në tërësi e bazuar dhe si e tillë u aprovua.

Nga provat e administruara është vërtetuar gjendja faktike si në vijim:

Me Kontratën e punës datë 01 shtator 2015, Leg.nr.2788/20 datë 16 nëntor 2020, është vërtetuar fakti se paditësi ka lidhur kontratë pune me të paditurën, përkatësisht Institucionin e arsimit Para universitar Shkolla “Shtjefën Kurti” Novosellë e Epërme, vendi i punës: teknik shërbyes, me kohëzgjatje të kontratës së punës 01 shtator 2015 – e përhershme.

Nga vërtetimi i datës 23 tetor 2020 i lëshuar nga SBASHK-ut vërtetohet se paditësi është anëtar i sindikatës në shkollën “Shtjefën Kurti”.

Nga vërtetimi nr.27, i lëshuar nga Shkolla “Shtjefën Kurti”, Komuna Gjakovë, me 23 tetor 2020, vërtetohet se këtu paditësi në institucionin e lartcekur, nga periudha 18 prill 2017 deri më 23 tetor 2020 ka gjithsej 672 ditë punë.

Gjykata duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit, datë 18 prill 2017, në të cilën në mënyrë të njëjtë është paraparë se: “Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restorantit apo kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim, për t’a bërë kompensimin”, si dhe duke u bazuar në Kontratën e punës së paditësit është vërtetuar fakti se e

paditësi ka lidhur kontratë pune me të paditurën, ndërsa vërtetimet e lartcekura dhe atë vërtetimi më numër protokollit 26/20, i lëshuar nga Shkolla “Shtjefen Kurti”, me 23 tetor 2020, vërtetimi i lëshuar nga SBASHK-u me datë 23 tetor 2020, vërtetojnë faktin se paditësi ka vijuar 672 ditë pune në shkollën përkatëse, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë, andaj gjykata marr parasysh kërkesën e paditësit për një kompensim të këtyllë, ia njohu shumën prej 1,344.00 euro, duke bërë përllogaritjen si në vijim: $672 \times 2.00 \text{ euro} = 1,344.00 \text{ euro}$.

Sipas nenit 8 par. 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës (Ligji nr. 04/L – 077), i publikuar në “Gazetën Zyrtare” të Republikës së Kosovës, nr. 16/2012, datë 19 qershor 2012 (i cili është në implementim nga data 20 dhjetor 2012), është paraparë se: “Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”. Për më tepër dispozita e nenit 245 par. 1 të LMD-së, ka paraparë se: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, prej nga rezulton se debitori, përkatësisht e paditura në rastin konkret është e detyruar që kreditorit, përkatësisht këtu paditësit në rastin konkret, të ia paguajë vlerën e kërkesëpadisë si dhe shpenzimet tjera aksesore, siç më detajisht është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kamatëvonesën gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 382 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku parashihet se “Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debitor, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”, tutje paragrafi 2 i këtij neni parasheh se “Lartësia e kamatëvonesës është 8% në vit, për veç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”, andaj meqenëse e paditura ka rënë në vonesë në kompensimin e obligimit sa i përket kompensimit lidhur me shpenzimet e shujtës ditore, që ka pasur ndaj këtu paditësit, gjykata vlerëson së përpos kërkesës kryesore, të njëjtës i takon edhe kamata e gjykuar sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u mor sipas nenit 452 par. 1 të LPK-së, dhe TA me ç’rast paditësit iu pranuan shpenzimet siç në poshtë vijon për pagesën e taksës gjyqësore për padi, shuma prej 20.00 euro, për përpilimin e padisë shume prej 104.00 euro, për pjesëmarrje në shqyrtimin përgatitor shuma prej 135.20 euro, përkatësisht shuma e përgjithshme prej 259.20 euro.

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
C.nr.807/2020, Datë 19 shtator 2022

G j y q t a r j a,
Afijete Sada - Gllogjani

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, Gjykatës së Apelit të Kosovës Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.